



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 4356/1, Prot.

Tiranë, më 12.10.2021

**Lënda:** Jepet informacioni i kërkuar.

**INSTITUTI SHQIPTAR I SHKENCAVE**

(Adresa: Rruga "Asim Vokshi", Pallati 13/25, Kati i 3-të)

**ZNJ. ARANITA BRAHAJ  
DREJTORE EKZEKUTIVE**

**TIRANË**

E nderuar znj. Brahaj!

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e Institutit që ju drejtoni, në përgjigje të kërkesës tuaj, regjistruar me aktin numër 4356 prot., datë 27.09.2021, në bazë të të dhënave që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dhe bazuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

- Z. Besmir Stroka është diplomuar në degën Drejtësi, titulli Jurist, Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi pranë Universitetit të Tiranës, në vitet 2005-2009 dhe në vitin 2015, ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës.
- Me Dekret nr. 8768, datë 31.10.2014, të Presidentit të Republikës, caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Me Dekret nr. 9654, datë 23.06.2016, të Presidentit të Republikës, emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Me vendim nr. 6, datë 21.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtari Besmir Stroka aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.
- Me vendim nr. 176, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, deklarohet përfundimi i periudhës së transferimit të përkohshëm përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe rikthimi në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.
- Me vendim nr. 397, datë 09.06.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konfirmohet në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 6 vite.
- Z. Besim Stroka, nuk ka vlerësime etiko-profesionale.
- Z. Besim Stroka, nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Z. Stroka disponon në dosje personale çertifikata trajnimi nga GIZ, Terres des Hommes dhe dëshmi e gjuhës së huaj, si më poshtë:

- Trajnim online me temë “Child victim friendly, restorative justice approaches and mechanisms” Terres des Hommes, zhvilluar më datë 25-26 shkurt 2021 dhe 11-12 mars 2021;
- Trajnim me temë “Judgecraft-soft skills”, zhvilluar më datë 4-8 qershor 2018, German Cooperation Przno, Mal i Zi.
- Trajnim me temë “Anti-Corruption and Money Laundry”, zhvilluar më datë 16-13 dhjetor 2013, Justice Academy of Turkey, Ankara, Turqi.
- Dëshmi e gjuhës së huaj anglisht, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, datë 04.07.2010.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

